

# **TAKIMI INFORMUES-PREZANTUES I PROJEKTIT NË BASHKINË KORÇË**

Data: 14 Nëntor 2024

Vendi: Bashkia Korçë

Organizator: Qendra "Trajnim Edukim Demokraci" (TED)

## **Hyrje dhe Qëllimi**

Takimi u zhvillua në kuadër të projektit “Të Rinjtë si Agjentë të Ndryshimit në Zbatimin e Nismave Rinore”, me qëllim ndarjen e informacionit mbi projektin, koordinimin me aktorët lokal dhe finalizimin e marrëveshjes për monitorimin e aktiviteteve.

### **1. Prezantimi i Projektit dhe Objektivat**

- Rritja e angazhimit të të rinjve;
- Nxitja e bashkëpunimit midis institucioneve lokale dhe të rinjve;
- Zhvillimi i aktiviteteve edukative dhe praktike.

### **2. Plani i Aktiviteteve dhe Përfshirja e Aktorëve Lokal**

- Bashkia Korçë: Mbështetje institucionale dhe logjistike;
- Shkollat pjesëmarrëse: Sensibilizim dhe mobilizim të rinjve;
- Organizatat e shoqërisë civile: Trajnime dhe ekspertizë;
- Komuniteti lokal: Promovim dhe mbështetje e aktiviteteve.

### **Konkluzione dhe Hapat e Mëtejshëm:**

- Nënshkrimi i marrëveshjes për monitorimin dhe zbatimin e projektit;
- Planifikimi i aktiviteteve të para informuese dhe trajnimeve;
- Përcaktimi i detyrave për aktorët e përfshirë;
- Organizimi i një takimi të dytë për vlerësimin e progresit.

### **Pjesëmarrës:**

- Përfaqësues të Bashkisë Korçë;
- Stafi i bashkive të angazhuara me projektin;
- Përfaqësues të shkollave të zonave përkatëse;
- Mësues nga shkollat pjesëmarrëse;

- Përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile;
- Anëtarë të komunitetit lokal.

Takimi shënoi një hap të rëndësishëm për zbatimin e suksesshëm të projektit. Bashkëpunimi efektiv mes Bashkisë Korçë, shkollave dhe organizatave të shoqërisë civile kontribuon në krijimin e një kulture pjesëmarrjeje aktive të të rinjve në zhvillimin e komunitetit.